



2



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRIŠTINU/ MUNICIPAL
MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj.37306/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Eljana Avni Naka nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6.parg.2 lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2. të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundervajtjet, me dt.17.11.2011 merrë këtë,

A K T V E N D I M

E PANDEHURA:Eljana Avni Naka e lindur me 13.3.1977 në Gjakovë,tani jeton në Prishtinë,e pa martuar, e gjendjes së mesme ekonomike,Fakultetin e Gjyhes Angleze të kryer, Sekretare e përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë,e gjendjes së mesme ekonomike

Ë s h t ë p ë r g j e g j e s

Sepse si Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë Tregtisë dhe Industrisë,nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë e njohtuar se është përfshirë në listen e Zyrtarve,të cilet janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë. Me veprim të këtill ka kryer kundervajtje nga neni 6 pika.2.lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në të holla në shumë prej **800 (tetëqind)** Euro, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formën e prerë. Në dobi të të hyrave gjyqësore të Kosovës,në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.

Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet në denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke ju llogaritur 15 EURO në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.Në emer të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 EURO, në afat dhe xhirrollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobes bëhet në të gjitha bankat e qytetit,kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë,me kërkesën nr.01-4108/11 të parashtruar gjykatës me datën 26.10.2011 për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës të permendur me lartë, për kundervajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës, ka zhvilluar procedurën kundërvajtëse dhe në seance verbale ka ndëgjuar të pandehurën e cili në mbrojtjen e vet deklaroi:Është e vertet se për vitin 2011,nuk e kam bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencionit Antikorrupsion,edhe pse kam qenë e njohtuar me formularët të cilët i kam pranuar në Imell,jam vonuar nga se kam qenë e ngarkuar me punë.Deklarimin e pasurisë e kam bërë me dt.27.10.2011.Si prova ja parashtroj gjykatës vendimin mbi emrimin, dhe vertetimin mbi deklarimin e pasurisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS		AGJENCIA PËR KUNDËR KORRUPSIONIN	
Dip. 03-4532/11		18.11.2011	
Nr. 01-4108/11		18.11.2011	
Nr. 01-4108/11		18.11.2011	

2.

Gjykatësi pas vlersimit të mbrojtjes së të pandehurës, dhe provave të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresave tjera të lëndës, erdhi në përfundim se e pandehura e ka kryer kundërvajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundërvajtjen të cilën e ka bërë.

Me rastin e caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari e pati parasysh peshën e kundërvajtjes, si dhe rrethanat tjera lehtësuese dhe renduese.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me këtë gjobë mund të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit.

Me sa u tha me lartë u vendos sin e dispozitiv te ketij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

Gjyqtari
Murat Paçarada

